

ANALIZA VJETORE E VEPRIMTARISË SË DEPARTAMENTIT TË AUDITIMIT TË PERFORMANCËS PËR VITIN 2024



II Shkurt 2025

Në zbatim të Urdhrit të Kryetarit të KLSH-së nr. 13 datë 16.01.2025, Departamenti i Auditimit të Performancës më datë 11.02.2025 zhvilloi në sallën “Lezh Kaczynski” në KLSH Analizën Vjetore për vitin 2024.

Analiza filloi me fjalimin hapës të Kryetarit të KLSH-së, z. Arben Shehu. Më tej, referuar edhe Axfordës, Drejtori i Departamentit të Auditimit të Performancës z. Aulent Guri prezantoi veprimtarinë audituese të Departamentit të Auditimit. Prezantimi ishte i fokusuar në Analizën e treguesve të auditimeve të performancës dhe sektorit të mjedisit për 2024, zbatimin e rekomandimeve në auditimet e mëparshme, bashkëpunimi me SAI homologe dhe institucione ndërkombëtare si dhe impakti në media i auditimeve të evaduar. Gjashtëmbëdhjetë (16) auditimet e performancës të realizuara në vitin 2024 kanë përfshirë 78 institucione të ndryshme si Ministri, Bashki apo edhe agjenci e institucione varësie. Në këtë auditime janë gjeneruar 235 gjetje, 126 konkluzione dhe 264 rekomandime, shifra këto të përafërta me një vit më parë. Edhe këtë vit Departamenti është fokusuar në çështje me impakt të lartë për taksapaguesit dhe qytetarët duke synuar përmirësim të shërbimeve, proceseve, programeve dhe politikave në tërësi të institucioneve publike. Fushat kryesore të audituara kanë qenë shëndetësia, arsimi, kultura, mjedisi, teknologjia e inovacioni si dhe aspekte sociale dhe barazisë gjinore.

Lidhur me 3 auditimet e përputhshmërisë të cilat ishin parashikuar të realizoheshin nga Sektori i Mjedisit në Departamentin e Auditimit të Performancës, është evaduar auditimi i përputhshmërisë në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë. Auditimi tjetër në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura është në faze raporti, ndërsa auditimi i 4 ARM-ve, Tiranë, Lezhë, Berat dhe Fier është rikthyer për auditim “në të nxehtë” me Vendimin e Kryetarit.

Gjatë vitit 2024, Departamenti i Auditimit të Performancës zhvilloi edhe 2 auditime për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme. Konkretisht, lidhur me auditimin e zbatimit të rekomandimeve për auditimet e performancës, nga 85 rekomandime të lëna në total, janë pranuar gjithsej 83 rekomandime nga subjektet dhe vetëm 2 nuk janë pranuar. Nga 83 të pranuarat, janë zbatuar plotësisht 33 prej tyre (39.8%), janë në proces zbatimi 15 (18.1%), janë zbatuar pjesërisht 17 (20.5%) dhe nuk janë zbatuar 18 (21.6%). lidhur me auditimin e zbatimit të rekomandimeve për auditimet e përputhshmërisë nga 24 masat e rekomanduara janë pranuar të gjitha ose 100 %. Nga këto, janë dhënë 23 masa organizative dhe 1 masë disiplinore e cila nuk është zbatuar. Sa i përket masave organizative janë zbatuar plotësisht 15 masa ose 65 % e tyre, janë zbatuar pjesërisht 4 masa ose 17.5 % e tyre dhe nuk janë zbatuar 4 masa ose 17.5 % e tyre.

ANALIZA VJETORE E VEPRIMTARISË SË DEPARTAMENTIT TË AUDITIMIT TË PERFORMANCËS PËR VITIN 2024

Departamenti i Auditimit të Performancës gjatë vitit 2024 ka vijuar bashkëpunimin me disa institucione homologe ndërkombëtare në disa auditime. Konkretisht janë realizuar:

- Auditimi i performancës me temë “Zbatimi i planeve të adaptimit ndaj ndryshimet klimatike”, auditim i kryer në bashkëpunim me IDI (INTOSAI Development Initiative).
- Auditimi i performancës me temë “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës” i realizuar në bashkëpunim me SAI-n e Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës.
- Auditimi i performancës me temë “Cilësia e ujërave në plazhe”. Ky auditim është në proces dhe po zhvillohet në bashkëpunim me SAI-n e Norvegjisë;
- Auditimi i performancës me temë “Shërbimi psiko-social në sistemin arsimor parauniversitar”. Ky auditim është në proces dhe po zhvillohet në bashkëpunim me SAI-n e Norvegjisë;
- Auditimi i performancës me temë “Siguria kibernetike në infrastrukturën kritike e Taxation” - Ky auditim është në proces dhe po zhvillohet në bashkëpunim me SAI-n e Norvegjisë.

Auditimet e performancës edhe gjatë vitit 2024 kanë gjetur jehonë në median e shkuar dhe vizive. Me dhjetëra shkrime, kronika, referenca dhe citime kanë reflektuar problematikat kryesore të evidentuara në auditimet e realizuara përgjatë vitit 2024.

Departamenti ka qenë aktiv gjithashtu edhe në trajnime, seminare e workshop-e brenda e jashtë vendit të organizuara nga Institucione të ndryshme Supreme Auditimi si dhe nga organizma ndërkombëtare si IDI etj. Workshop-et, trajnimet dhe takimet kryesore në të cilat auditues të ndryshëm të Departamentit kanë marrë pjesë kanë qenë:

- Simpozium ndërkombëtar - EUROSAI Emerging Issues, Lisbonë Portugali;
- Simpoziumi i 26-të i UN/INTOSAI me temë “Zbatimi i OZHQ nr. 13 mbi masat e ndërmarra për përshtatjen apo zbutjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe pasojat e saj: Roli, kontributi dhe përvoja e Institucioneve Supreme të Auditimit”, Vjenë Austri;



- Trajnim i avancuar për Auditimin e Performancës, Ankara, Turqi.
- Certificate in Audit Quality Management Specialist (AQMS), Manila, Filipine, (Aktivitet i IDI).
- Vizitë suport për SAI -n e Lesotos në kuadër të kryerjes së vlerësimit sipas SAI PMF – Maseru, Lesoto. (Aktivitet i IDI).

Në Analizën Vjetore të Departamentit u prezantuan gjithashtu disa prej auditimeve më të spikatura të vitit 2024 dhe konkretisht:

- Respektimi i standardeve në trajtimin dhe eliminimi i mbetjeve spitalore, në parandalimin e rrezikut për shëndetin e personelit shëndetësor, pacientëve dhe mbrojtjen e mjedisit;
- Efektiviteti dhe siguria e barnave që qarkullojnë në Shqipëri;
- Procesi i birësimit të fëmijëve dhe garantimi i të drejtave të tyre për mirëritje dhe edukim;
- Politikat dhe respektimi i të drejtave të personave me probleme të shëndetit mendor në shërbimin spitalor Psikiatrik.

Në vijim, gjatë Analizës u diskutua mbi ecurinë dhe objektivat kryesore të Departamentit për vitin 2025. Kujdes të shtuar nevojisin aspekte që kanë të bëjnë me vlerësimin e 3- E-ve, (Efektivitetit, Eficiencës dhe Ekonomicitetit), formulimin e gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve si dhe identifikimin e kriterëve audituese.

Në mbyllje të Analizës, Kryetari i KLSH-së theksoi nevojën e angazhimit të të gjithë audituesve të Departamentit lidhur me propozimin e temave audituese aktuale dhe me impakt gjatë gjithë vitit kalendarik. Kryetari i KLSH-së bëri thirrje gjithashtu për shtim të komunikimit, ndërveprimit dhe bashkëpunimit jo vetëm midis audituesve brenda Departamentit dhe KLSH-së por edhe me SAI e institucione të tjera ndërkombëtare.